



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 114/13
Prishtinë, më 10.07.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri, Sevdije Lama, Hykmete Bajrami dhe Duda Balje.

Mungoi: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku, Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Mustafë Mustafa, Mentor Shala, Adelinë Valla, Ramadan Pacarizi, Rejhane Zyfiqaj(GIZ).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj-Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura të Komisionit, dt. 03.07.2013;**
3. **Shqyrtimi i Raporti të të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-qershor 2013 dhe Projektioneve të të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së për periudhën korrik-dhjetor 2013;**
4. **Shqyrtimi i i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur Projektligjin për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstaton se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura të Komisionit, dt. 03.07.2013

Kryetarja konstaton procesverbalin miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raporti të të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-qershor 2013 dhe Projektioneve të të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së për periudhën korrik-dhjetor 2013

Kryetarja ne kemi kërkuar nga RTK-ja që ta na paraqes shpenzimet për gjashtë mujorin e parë dhe një plan se si i parasheh shpenzimet për gjashtëmujorin e dytë, meqenëse financohet nga Buxheti i Kosovës dhe RTK i ka sjellur këto dokumente.

Rrahman Paçarizi RTK-ja për herë të parë është në gjendje të flas për një afarizëm pozitiv, ku për një periudhë prej gjashtë muaj kemi arritur ta paguajmë një shumë të madhe të borxheve.

Mentor Shala theksoi se në këtë viti RTK-ja ka hyrë me borxhe të mëdha, po edhe me plane shumë të mëdha pasi që jemi në fazë e digjitalizimit ku jo vetëm ne si RTK, ku për këtë duhen shumë mjete. Borxhet kemi arritur që brenda gjashtë mujorit ti paguajmë 1 mijonë e 500 mijë dhe konsideroj se ky është një sukses sepse duhet ti paguajmë borxhet dhe të merremi me qështje investive. Gjithashtu kemi arritur ta hapim kanalën e dytë të RTK-së dhe kemi planifikuar të hapim edhe kanale tjera gjatë këtij viti dhe planifikojmë të hapim edhe kanalën në youtube i cili do të na sjell edhe të hyra. Jemi munduar t'i përmbahemi vijës buxhetore po në disa kategori kemi tejkalime e të disa kursime.

Albana Fetoshi theksoi se nga raporti, shifet se tek kategoria Paga dhe Mëditje ka tejkalime prej 6% nga ajo që është planifikuar, a është numri i të punësuarve apo pse është ky tejkalim? Edhe tek mallrat dhe shërbimet, kemi tejkalim prej 31% , cila është arsya për një tejkalim kaq të madhë?

Adelina Valla tek kategoria Mallra dhe Shërbime ka një tejkalim prej 6% , arsyeja pse është bërë ky tejkalim është shëndërimi i kontratave të perkohshme në kontrata të rregullta, të cilat i ka obliguar kontrata kolektive në bazë të ligjit për marrëdhëniet me punë, gjithashtu në këtë kategori ka ndikuar edhe sistematizimi i vendeve që është bërë në këtë periudhë. Ndërsa në kategorinë Mallra dhe Shërbime ka ndikuar që të jetë kjo rritje sepse me miratimin e Ligjit të TVSH-së për zbritje RTK-ja asgjë ska përfituar nga ky ligj dhe kjo shumë prej 16% vetëm sa i ka ngarkuar shpenzimet sepse TVSH-ja, nuk ka mundur të llogatitet e zbritshme, gjithashtu dihet se RTK-ja ka ngjarje sportive që kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve.

Albana Fetoshi RTK-ja ka borxh prej 4 milion euro, a mund të na tregoni se kujt i keni borxh dhe sa prej këtij borxhi është paguar?

Mentor Shala borxhet i kemi prej bashkëpunitorve të jashtëm dhe producentët e jashtëm, gjithashtu kemi borxhe edhe EBU për programe të ndryshme sportive ku vetëm televizioni publik mund t'i transmetojë, pastaj kemi shërbimet të cilat ne vazhdimisht i marrim nga EBU që janë këmbimet, materialet e ndryshme që tash na faturohen.

Latif Gashi theksoi se në krahasim me raportet tjera kemi një raport mirë të përgaditur, shihet se ka një menaxhim më të mirë. Po na gëzon fakti se keni filluar ti paguani borxhet mirëpo mos i paguani borxhet duke hyrë në borxhe.

Xhevdet Neziraj theksoi si komision jemi të interesuar që të shkoj dinamika në bazë të planifikimit. Përveç tejkalimit në paga për mua është shqetësuese mosrealizimi tek investimet kapitale por edhe tek të hyrat e buxhetit të planifikuar me një diferencë prej 270,000€. Konsideroj që si Komision se kemi qenë të përgjegjshëm ndaj RTK-së dhe jemi të interesuar në mediat publike, ndoshta si individ nuk jam i kënaqur me politikat mediale dhe jam në pritje të ftesës së drejtorit për konsultim, por në aspektin buxhetor duhet të ketë realizim ashtu siç është planifikuar pasi që mund të ketë debat nga deputetët e tjerë për këtë çështje.

Hykmete Bajrami sa i përket tejkalimeve në *Mallrave dhe Shërbimeve*, në javët e kaluara kemi kthyer raportin e Auditorit Gjeneral për një tejkalim prej 5% kurse këtu kemi një tejkalim 31% dhe sërish ndëgjoj nga kolegët se keni një menaxhim më të mirë. Justifikimi se është bërë lirim i mjeteve nga TVSH-ja nuk ka arsyeje, për faktin se TVSH-ja është 16% dhe nuk është 31% dhe se kur janë bërë lirimet e mediave nga TVSH-ja e keni pas të ditur se cilat aktivitet lirohen dhe cilat nuk lirohen pra nuk kam njohuri se kemi pasur zbritje të buxhetit për shkak se mediat janë liruar nga TVSH-ja. Poashtu më shqetëson se ku janë siguruar këto mjete nga cila kategori keni pas lëvizje? Mendoj se RTK-ja po kalon mirë nëpër Komisione për faktin se është televizion publik, deputetët i kanë frikë kamerat pasi që shpesh herë mund të jemi pjesë e ekranit në mënyrat që ju konvenon juve. Do të dëshiroja të mos përdorim standarde të dyfishta.

Kryetarja sqaroi se Raporti i Auditorit nuk është kthyer për shkak të tejkalimit prej 5% por për shkak të mosharmonizimit të tabela e shpenzimeve për Mallrat dhe Shërbimet, dy tabelat kanë qenë të ndryshme për 5%. Dhe arsye tjetër ka qenë për shkak të mosinformimit të të dhënave për numrin e të punësuarve të cilët i ka në institucion. Nga ajo që është planifikuar vërehet tejkalimi prej 7000€ por jemi shumë të ndishëm në raport me krijimin e borxheve të cilat i ka institucioni. Është e kuptueshme që RTK-ja ka trashëguar borxhet nga viti në vit, sidomos në periudhën kur nuk ka qenë e definuar çështja e pagesës. Do të ishte mirë që planifikimi të bëhet ashtu siç janë mundësitë dhe shpenzimet sipas mundësive pasi që kërkesat janë më të mëdha.

Latif Gashi theksoi se qendrimi i tij nuk është kuptuar drejtë, theksova se raporti aktual krahasuar me raportet e viteve paraprake paraqet menaxhim më të mirë dhe përgjegjësi më të lartë, duke marrë parasysh vështirësitë e RTK-së me rastin e ndalimit të pagesës nga ana e KEK-ut. Po ashtu kam dhënë vërejtjen time lidhur me tejkalimin e shpenzimeve në raport me planifikimin duke kërkuar që të ardhmën të mos ketë deficit pavarësisht që bëhen pagesat e borxheve.

Duda Balje nga të dhënat e raportit shifet se duhet të hapen edhe dy kanale, kanali youtube por dhe kanalet në gjuhët tjera, sipas amendamentit që është futur në ligj, që në bazë të kushteve teknike dhe financiare për hapjen e kanalit edhe për komunitetin boshnjak. A keni planifikuar mjete për hapjen e këtyre kanaleve?

Mentor Shala sqaroi se me ligjin e RTK-së thuhet se varësisht nga kushtet kur të krijohet mundësia financiare të hapet kanali për komunitetin jo serb, por dua të sqaroj se dy kanale që do të hapen tani(RTK news dhe RTK 4) nuk do të kenë implikime në staf, punohet me staf të njejtë të punëtorve. Për hapjen e një kanali të ri në gjuhën e komuniteteve duhet të pranohet staf i ri që do të ketë implikime buxhetore ndoshta me 1,000,000 € mund të hapet kanali i ri. Pra, në momentin e parë që do të krijohet mundësia financiare do të respektojmë ligjin sa i përket hapjes së kanalit të ri.

Hykmete Bajrami kërkoi përgjegje lidhur me pyetjen paraprake se ku i kanë siguruar mjetet për rritjen e *Mallrave dhe Shërbimeve*?

Adelina Valla sqaroi se projeksioni i të hyrave të RTK-së është bërë nga ndarja e mjeteve nga Kuvendi i Kosovës, më saktë shuma prej 200,000€ i është ndarë RTK 2 për investime kapitale. Sa i përket investimeve kapitale që buxheti ka mbetur i pashfrytëzuar më duhet të theksoj se është përfshirë shkalla e amortizimit të pajisjeve dhe investimeve që RTK-ja ka investuar. Kurse për pjesën e TVSH-së RTK-ja nuk ka pasur profit për shkak të mjeteve të liruar nga Kuvendi për TVSH kurse tek shpenzimet 16% e ka ngrakuar. Një pikë tjetër janë edhe kontratat e viteve paraprake. Kemi paraqitur mjetet që janë paguar, që i kemi obligim, kemi paguar atë sa kemi pas buxhet kurse pjesa tjetër ka mbetur për gjashtë mujin e ardhshëm.

Kryetarja meqenëse çështja e borxheve të RTK-së është bërë objekt diskutimi kërkoj nga RTK-ja që brenda muajit të paraqes Komisionit një raport për borxhet e trashëgura nga viti në vit, kur janë krijuar këto borxhe si dhe planifikimin sesi do të mbuloj gjatë viteve?

Pas diskutimeve, Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, Duda Balje), një Kundër(Albana Fetoshi) dhe një Abstenim(Hykmete Bajrami), nxorri këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kryesisë të miratohen projektsonet e të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik-dhjetor 2013 dhe Administrata e Kuvendit, të transferojë mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirollogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2013, në shumën prej 2,140,250 Euro.
2. Radiotelevizioni i Kosovës, mës së voni deri më 30 tetor 2013, të dorëzojë në Kuvend, planin e shpenzimeve të RTK-së për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2013, në bazë të së cilit Administrata e Kuvendit transferon mjetet buxhetore për atë periudhë buxhetore, në vlerë prej 2,140,250 Euro.
3. Radiotelevizioni i Kosovës, t'i dërgojë Komisionit për Buxhet dhe Financa një raport të detalizuar për shumën e borxhit të akumuluar deri më tani nga RTK, rrjedhën e krijimit të këtij borxhi dhe planin për mënyrën dhe afatet kohore për shlyrjen e borxhit.

4. Shqyrtimi i i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur Projektligjin për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës

Kryetarja theksoj se është formuar grupi punues për analizimin e çështjeve që kanë të bëjnë me buxhetin dhe se puna ka përfunduar.

Latif Gashi njoftoi për takimin e mbajtur nga grupi punues, ku gjatë takimeve kanë qenë pjesëmarrës përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë së Financave. Sa i përket ligjit nga ana buxhetore ligji është i rregulluar nuk paraqet pengesë për aprovim. Problemi qëndron se nëse jemi jo të mobilizuar si Komision, nuk japim sqarime të mjaftueshme dhe nuk kërkojmë nga seanca të kthehet në Komision për Legjislacion i cili i ka ndarë votat dhe nuk kanë arritur të formojnë një grup punues duke rregulluar kështu çështjen ku thuhet se ka mospërputhje me Kushtetuten. Zyra e Kryeministrit ka ofruar sqarime dhe amendamente.

Albana Fetoshi pyeti se në bazë të përmbajtës së amendamentit të propozuar nga grupi punues, a do të thotë se Komisioni për Buxhet dhe Financa, do ta caktoj kompensimin për dy anëtarët e Bordit deri në miratimin e ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publik?

Kryetarja konstatoi se derisa të hyn në fuqi ligji për pagat e funksionarëve të lartë publik, komisioni do të shqyrtoj këtë qështe dhe do të rekomandoj përmes Kryesisë. Po ashtu njoftoj se ka marrë pjesë në një takim për ligjin dhe ka paraqitur mendimin e saj.

Pas diskutimeve, Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, Duda Balje) dhe dy Abstenime (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Kundër, nxorri këtë

Rekomandim

1. Projektligji për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të paragrafit 2 të nenit 6.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamentin si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 6, paragrafi 7 riformulohet si në vijim:

7. Anëtarët e Bordit marrin kompensim për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit. Kompensimi i anëtarëve të Bordit, caktohet me Ligjin për Pagat e Funksionarëve të Lartë Publik. Deri në miratimin e Ligjit për Pagat e Funksionarëve të Lartë Publik, kompensimi i anëtarëve të Bordit caktohet nga Kuvendi, me rastin e miratimit të buxhetit të Agjencisë

5. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi se pasi që rfishikimi i buxhetit është pikë e rendit të ditës së nesërme të Seancës Plenare, nëse kalon në Seancë rekomandoj që të punojmë për pjesën tekstuale, ta shqyrtojmë në mbledhjen e radhës pas shqyrtimit të Raportit të BQK-së dhe me pjesën tabelare të fillojmë nga dita e hënë.

Hykmete Bajrami konsideroj se gjatë javës së ardhshme na nevojitet dy orë të lira pasi dëshirojmë të mbajmë takim me operatorët teknik si palë të interesit të këtij ligji. Sa i përket plotësimit/ ndryshimit mendoj se duhet të punojmë me një orar më të ngarkuar për të përfunduar më shpejtë.

Kryetarja theksoj se mund të bëhet caktimi i takimit me palët e interesit. Shpresoj se brenda javës së ardhshme do të përfundojnë punët.

Rejhane Zylfijaj njoftoj se Bordi i FMN-së pret informimin për përfundimin e rishikimit të buxhetit nga Komisioni jonë për të mos u prish marrëveshja.

Hykmete Bajrami propozoj që nëse bëhet vazhdimi i Seancës Plenare për ditën e premte të shtyhet raporti i BQK-së për mbledhjet e radhës dhe të punohet për pjesën tekstuale të Projektligjit.

Mbledhja përfundoi: 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona